

# Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës

## Aspekti gjinor dhe Puna ne Polici - Aplikimi i Perspektives Gjinore për Tejkalimin e Sfidave Konkrete

### Grupi 1: Mentaliteti Shoqërisë

\* Problemi fillestar me të cilin policet femra përballen është vendimi për të ndjekur një karrierë në polici. Sipas të dhënave nga terreni, shumica e grave kanë pasur probleme për t'i bindur familjet dhe kolegët e tyre në lidhje me vendimin e tyre për t'u angazhuar në këtë profesion, pasi që puna e policisë nuk shihet si e përshtatshme për gratë dhe për këtë arsye ata e pranojnë këtë vendim me disa vështirësi. Përveç kësaj, ka pasur raste kur punonjëset e policisë femra kanë hasur vështirësi në kryerjen e detyrave të tyre, përkatësisht në fushë dhe në drejtimin e trafikut.

### Grupi 2: Ndërrimet e natës

\* Ndërrimi i natës është një tjetër segment që përbën një vështirësi për oficeret femra të policisë. Ekzistojnë disa faktorë që pengojnë punën në ndërrim të natës. Fillimisht ka probleme që mund të hasen brenda familjes, nga burri apo anëtarët e tjerë të familjes, dhe pastaj mund të paraqiten çrregullime të gjumit dhe mungesa e dritës që drejtpërdrejt mund të ndikojnë në gjendjen psikologjike dhe kështu të paraqesin probleme të tjera për ti kryer detyrat policore. Kjo në masë të madhe ndikon tek nënat gjidhenese, por ka edhe obligime të tjera familjare të vendosura mbi supe të grave nga familja, pavarësisht nga profesioni i tyre.

### Grupi 3: Pushimi i lehonisë

\* Pushimi i lehonisë është shumë i shkurtër dhe përbën një problem serioz për gratë në përgjithësi dhe në veçanti për oficeret femra të policisë. Në parim, pushimi i lehonisë zgjatë 3 muaj të pushimit me pagese dhe 3 muaj të tjerë paguhen nga buxheti i Qeverisë së Kosovës deri në 70 për qind të pagës minimale në Kosovë. Pushimi i pamjaftueshëm i lehonisë është një problem serioz për foshnjat e sapolindura, sepse ata mbahen larg nga nënat e tyre në një periudhë shumë të ndjeshme. Përveç kësaj, pushimi i pamjaftueshëm i lehonisë i detyron nënat të punësojnë kujdestare dhe shpenzimet për aktivitete të tilla mezi mund të mbulohen nga paga aktuale që policët marrin. Kjo është një pengesë që ndalon nënat me fëmijët e porsalindur që të rifillojnë karrierën e tyre policore. Sipas informatave të dhëna, nënat e reja hasin në mirëkuptim nga eprorët e tyre, por kjo paraqet një çështje shumë serioze që nuk mund të lihet vetëm në mëshirën e eprorëve ose menaxherëve të personelit dhe për këto arsye një zgjidhje e përshtatshme duhet të gjendet dhe të përcaktohet qartë me ligj ose rregullore.

### Grupi 4: Abuzimi seksual / ngacmimi

\* Pavarësisht numrit të kufizuar të incidenteve të abuzimit apo ngacmimit seksual në vendin e punës, besohet se në fakt ka raste të frikësimit seksual që paraqiten në vazhdimësi. Në shumicën e rasteve është kërkuar ndihma e një psikologu për të përballuar këtë situatë emocionale sa më lehtë. Megjithatë, ende hezitohet në raportimin e këtyre rasteve. Në bazë të të dhënave nga terreni, është vërejtur se ekziston mungesa e besimit nga femrat police se rasti i raportuar për frikësim seksual do të zgjidhet. Një problem tjetër është fakti se ende mbetet e panjohur se sa oficerë policie femra janë të njoftuara me atë se si duhet vepruar për ti adresuar këto probleme dhe sa janë të njoftuara me të drejtat që gëzojnë ato brenda Policisë së Kosovës, apo për shkak të rrethanave që viktimat vuajnë kjo mund të ndikojë në mungesën e informacioneve në lidhje me procedurat.

Një tjetër shqetësim madhor është mungesa e konfidencialitetit apo besimit në kuadër të Policisë së Kosovës, pasi që në disa raste jeta e një oficeri policie femër-pas raportimit të rastit të

ngacmimit/abuzimit seksual - bëhet e padurueshme dhe rrëfimi i saj ishte vetëm një pikë diskutimi nga kolegët e saj.

\* Tekst marrë nga, 'Raport mbi pozitën e grave në Policinë e Kosovës'.

## S. A. R. A. Metode e zgjidhjes se problemit

**Perspektiva gjinore** – cilat jane pervojat, kerkesat dhe shqetesimet e femrave dhe meshkujve? Sa ndryshjone? Sa kane mirekuptim reciprok?

**Perspektiva Organizative/Perspektiva Operative** – Si do të ndikojë kjo ne përmirësimin e zhvillimit te organizates dhe efikasitetin operativ të policisë?

### Kerkim

1. Cili eshte problemi?
2. Kush preket nga problemi?  
*Mendo larg/gjere!*
3. Kush mund te ju ndihmoje ne kuptimin aspekteve shtese te ketij problem? Ekspertet?
4. Kush mund te ju ndihmoje ne pergjigjjen, reagimin ndaj ketij problemi? *Aleatet?*

### Analize

1. A eshte ky problem unik per Policine, apo problem me l gjere shoqerore ?
2. Cili eshte shkaktari rrenjesore l problemit? A eshte aspekti gjinore?
3. Cka/Kush i jap mundesi problemit per te vazhduar? Kush/Cka eshte duke e injoruar problemin ne menyre eksplicite apo implicite?
4. Çka, nëse do te ekzistonte ndonjë instrument/shkelje ligjore apo politika ? A do ta rriste kjo mundesine apo aftësinë tuaj për të zgjidhur problemin?

### Pergjigjja

1. Cial eshte zgjidhja juaj apo rekomandimi? Si do ta zgjidhte kjo problemin?
2. Cfare hapa, veprime jane te nevojshme?
3. Kush duhet te kycet ne menyre

|   |  |
|---|--|
| <p>qe te mund te jap perkrahe,promovoje zgjidhjen ?</p> <p>4. Si do te ndikojte kjo zgjidhje ne rritjen e efikasitetit operativ dhe organizativ te punes se policies?</p> |  |
| <p><b>Vleresimet</b></p> <p>1. A ishte zgjidhja juaj efektive – pse apo pse jo?</p>   | <p>Nuk ka nevojë për të përfunduar këtë seksion - por ky seksion mund të jetë i dobishem pas zbatimit apo implementimit aktual, në mënyrë për të identifikuar nëse ishte apo jo ajo zgjidhje efektive.</p> |